

PËR ZGJEDHJET

- Është shumë e rëndësishme të përsërisim deri në mërziti, pa u lodhur 2 gjëra
 1. Të gjitha gjetjet kryesore të raportit të OSBE/ODIHR
 2. Këto janë votime të paligjshme.

Të tjera pika të rëndësishme:

3. Për herë të parë me një parti
4. Për herë të parë përjashtohet opozita nga komisionet
5. Edhe pse me vetëm një kandidat nuk lanë as mundësinë në fletë votimi të votohej kundër por vetëm një kuti ku mund të votohej vetëm pro.
6. Edhe Fronti Demokratik në komunizëm kishte formalisht dy kuti një Pro një Kundër.
7. Edhe pse vetë kandidoi, vetë votoi dhe vetë numëroi, i manipuloi të gjitha
8. Edi Rama manipuloi edhe një proces që e kontrollonte të gjithin vetë dhe kjo tregon edhe njëherë se me të nuk mund të ketë zgjedhje të lira.

Zgjedhjet ishin të paligjshme, sepse dekretin e presidentit nuk mund ta gjykojë askush tjetër veç Gjykatës Kushtetuese.

- Edhe nëse pyetemi për motin, ne duhet të themi “sipas raportit të OSBE/ODIHR”
- Nuk duhet të komentojmë çdo pyetje që na bëhet.
- Jo çdo pyetje duhet të marrë një përgjigje që të përbëjë lajm patjetër.
- Ne duhet të mësohemi të mos i japim përgjigje çdo gjëje dhe sipas rastit t’i themi atyre që nuk kemi koment apo kjo pyetje nuk ka rëndësi për thelbin e çështjes.
- Është e rëndësishme të jemi konçizë.

GJETJET E OSBE/ODIHR

Gjetjet e OSBE/ODIHR theksojnë se 30 qershori nuk ishte në interesin e qytetarëve shqiptarë. Votimet ishin të paligjshme.

Problemet më serioze të gjetjeve ishin

- votimet pa zgjedhje,
- përjashtim i padrejtë i opozitës nga administrimi dhe monitorimi i zgjedhjeve, mosfunksionimi i gjykatave,
- vendime të gabuara të KQZ-së,
- marrje e kompetencave të Gjykatës Kushtetuese. **(gjetjet e tjera janë të detajuara në dokumentin që ju ka dërguar Sekretari i Përgjithshëm)**

PËR PRESIDENTIN:

Ne kemi vlerësuar përherë përpjekjet e Presidentit për zgjidhjen e krizës. Por qëndrimi ynë është i pandryshuar: ne nuk hyjmë në zgjedhje pa largimin e Edi Ramës dhe nxjerrjen e drejtësisë së atyre që vodhën zgjedhjet në bashkëpunim me krimin.

Për qëndrimet e tjera të Presidentit ne nuk kemi asnjë koment. (Këtu përfshihet edhe çështja e Sorosit)

PËR QENDRIMIN E SHBA DHE BE:

Ne nuk komentojmë qëndrimet e SHBA dhe BE. Qëndrimi ynë për zgjedhjet është i qartë: ne nuk i njohim këto zgjedhje, pasi ato janë të paligjshme. OSBE-ODIHR ka konfirmuar që këto zgjedhje janë të paligjshme. Manipulimet e shumta që u zbuluan vertetojnë qëndrimin tonë se Edi Rama nuk mund të organizojë zgjedhje të lira dhe të ndryshme. Ai vodhi edhe votat e veta.

PËR KRYEBASHKIAKËT:

Është fakt është se:

vetëm 6.66 përqind e qytetarëve të Shkodrës kanë votuar,

vetëm 7.7 përqind në Kavajë,

vetëm 9.6 përqind në Kamëz

vetëm 9.1 përqind për Vaun e Dejës

vetëm 10.68 përqind për Lezhën,

vetëm 9.8 përqind e qytetarëve të Rrogozhinës

vetëm 11 përqind për Pogradecin

vetëm 3215 votues të qytetarëve të Tropojës nga 21872

vetëm 6289 nga 44 355 votues në Kukës

vetëm 12.6 përqind votues për Matin

vetëm 5830 votues nga 33 566 ose 17%

vetëm 5512 votues nga 29316.

vetëm 5935 nga 31 mijë 535 votues në Mallakstratën

Po kështu është për Selenicën, Përmetin, Dropullin, ku kanë votuar vetëm 1676 nga 20 mijë e 6 votues.

Emrat që do të dalin nga votimet e paligjshme të 30 qershorit janë rezultat i zgjedhjeve të paligjshme, dhe në kundërshtim me vullnetin e thujse të gjithë votuesve të Shkodrës, Kavajës, Lezhës, Kamzës, Tropojës dhe bashkive të tjera.

Në këto kushte cdo përpjekje për zaptimin e bashkive është e paligjshme dhe do të trajtohet si e tillë.

Cfarë do të thotë kjo??? Cfarë do bëni???

- Ne i konsiderojmë të paligjshme dhe do e trajtojmë si të paligjshëm cdo përpjekje për pushtimin e bashkive.
- Se si vendos ti përgjigjet populli, banorët e këtyre bashkive, këtë nuk mund ta parashikojmë sot dhe nuk ka njeri që e parashikon dot!

REZULTATI I 30 QERSHORIT

Shqiptarët braktisën në masë maskradën e votimit një partiak të Edi Ramës. 85 përqind e votuesve të regjistruar refuzuan votimet e paligjshme moniste. 85% e shqiptarëve duan ndryshim. Kjo është e vetmja vlerë e 30 Qershorit. Gjithçka tjetër është farsë e paligjshme, antikushtetuese.

Edi Ramën sot e bojkotuan edhe socialistët, pasi për të sot votuan më pak se në vitin 2015 dhe 2017. Thuajse e gjithë vota e sotme është vota e sektorit publik, e rrogëtarëve të shtetit, e marrë në dhunim të vullnetit të lirë të tyre dhe familjarëve.

Jo të gjithë ata që e refuzuan janë me PD. Sfida jonë është të qëndrojmë të bashkuar me kauzën e zgjedhjeve të lira e të ndershme derisa t'i arrijmë, pastaj t'i bindim se ne jemi alternativa më e mirë për vendin.

Shqipëria ka fituar. Vota më e pastër është refuzimi nga 85% i shqiptarëve.

Megjithëse kandidonte vetë, votonte vetë, numëronte vetë dhe çertifikonte vetë, votimet u karakterizuan nga manipulime masive.

Rezultati provon çdo akuzë tonën kundër Edi Ramës. U provua se me Edi Ramën në krye nuk mund të ketë zgjedhje të lira dhe të ndershme.

As kur voton vetë numëron vetë dhe shpall vetë rezultatin nuk arrin dot pa manipulime massive.

Shqiptarët nuk janë të përçarë, por janë të bashkuar rreth vlerave europiane, lirisë, demokracisë, votës së lirë. Kanë identifikuar Edi Ramën si armikun e lirisë dhe duan të largohet.

- PD dhe opozita doli më e fortë dhe më e bashkuar nga 30 qershori.
- Plani i Ramës ishte të përcante opozitën, të përcante PD.
- Planin e konfirmon edhe sms që META bëri publike sot.
- Ndaj krijoi BD dhe nxiti njerëz të kontrolluar prej tij të sulmonin PD.
- ODIHR konstatoi se BD dhe pseudokandidatët e saj u regjistruan në kundërshtim me ligjin.
- Por plani i Ramës për të përcarë PD dhe opozitën përmes BD, deputetët e blerë në Parlament dhe të tjerë mercenarë dështuan.
- Ja dështuan shqiptarët që e refuzuan masivisht.
- 85% përqind e shqiptarëve ju përgjigjën masivisht thirrjes së PD për refuzim të farsës.

Të gjithë së bashku, si qytetarë, jemi sot më të bashkuar dhe më të fortë se kurrë më parë.

Edi Rama doli më i vetmuar dhe më i dobët nga 30 qershori. Edi Rama e ka katandisur PS në parti rrogëtarësh, parti mercenarësh, parti banditësh. Atë e mbështesin vetëm për para.

- **MANIPULIMI, KQZ**

- Për shkak të refuzimit masiv nga shqiptarët, njerëzit e tij kanë mbushur kutitë e votimit kudo në Shqipëri.
- Kudo dalin më shumë vota në kuti sesa ishte pjesëmarrja zyrtare e deklaruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
- KQZ drejtoi operacionin e manipulimit gjithë ditës së dielë me pjesëmarrjen e votuesve dhe po vazhdon edhe tani që flasim
- Asgjë nuk rakordohet. Të gjitha QV skandaloze.
- Gjithcka ishte e paracaktuar.
- Denar Biba urdhëronte rezultatin që duhej shpallur. Pastaj urdhëronte KZAZ që të njoftonin atë rezultat. Pastak KZAZ urdhëronin KQV që të arrinin objektivin.

- Në këtë panik e kaos dolën zbuluar
- Shikoni vetë procesverbalet zyrtare të KQZ: Shpallën në ora 11 se kishin marrë pjesë 12 përqind dhe në procesverbal duket qartë që është vetëm 6 përqind.
- Tregoni tabelën që denoncoi Gazment Bardhi.
- Shikoni se i ka nxjerrë media sesi ka më shumë vota të numëruara sesa vota të hedhura në 21 bashki.
- Kandidatët kanë marrë deri në 137% të votave të hedhura!!!

Ndryshe nga çdo herë të tjetër, Komisioni Qendror i Vjedhjeve nuk i ka nxjerrë të dhënat e pjesëmarrjes në votime nga sistemi online i përpunimit të të dhënave, por nga telefonatat e një grupi informal në KQZ- drejtuar nga militant të Partisë Socialiste.

Kjo mënyrë, e zgjedhur për të mos lënë gjurmët e manipulimit në sistemin e të dhënave, zhbën alibinë e trashë të KQZ-së për të fshehur krimin e manipulimit të numrit të pjesëmarrësve.

Nuk ka ndodhur kurrë më parë, në asnjë palë zgjedhje, sado të kontestuara të kenë qenë ato, që të ketë mospërputhje të tilla masive me shifrën zyrtare të pjesëmarrjes me votat që gjenden në kuti.

Ky është një proces i diskretituar. Është një proces nul, jashtë çdo standardi minimal demokratik.